

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Minir Hoti, dhe sekretaren juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të pandehurit I. Q. F. nga fshati B. komuna P., për shkak të veprës penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj nga neni 330 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/II.nr.5972/14 të datës 06.06.2016, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur në praninë e Prokurorit të Shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe të pandehurit I. F., pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik më dt.02.02.2017, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: I. F., nga i ati Q. dhe e ëma H. e vajzërisë R., i lindur më datë *data e lindjes...* në fshatin R. komuna e P. me vendbanim në fshatin B. komuna e P., me nr. personal *numër personal...*, ka të kryer shkollën e mesme , i pa punë, i martuar, baba i 4 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptarë, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Sepse:

Më datë 26.07.2014, rreth orës 02:00, në depon e qeramikave “Te M.” në rrugën “...” në P., nga patrulla e policisë është zënë në flagrancë i pandehuri I. F. i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore e përvetëson pasurinë e cila i është besuar atij pasi që punonte në këtë depo si rojtar dhe ka pas detyrim ligjor ndaj pronarit të pasurisë F. A. që ta ruaj atë e jo ta përvetësoj me çka i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material të dëmtuarit.

- Më këtë ka kryer veprën penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj nga neni 330 par.2 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4,7,17,41,45, 46, 73 dhe 330 par.2 të KPRK-së, si dhe nenit 365 dhe 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

Të pandehurin **I. F.** me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2 (dy) muaj** të cilin dënim është i obliguar ta mbajë në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe me dënim me gjobë në shumë prej **200 Euro (dyqind euro)**, të cilin dënim, është i detyruar t’a paguajë në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë, atëherë gjykata do t’ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke ia llogaritur 1 (një) ditë burgim, me njëzet (20) Euro të gjobës.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj sipas listës përfundimtare të shpenzimeve të shkaktuara të gjykatës kurse paushallë gjyqësor të paguaj

shumën prej **20 Euro** (njëzetë euro), brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari F. A. pronar i sallonit të qeramikës “Te M.” në P. rruga “...”, për realizimin e kërkesës pasurore udhëzohet në kontest juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP/II.nr.5972/14 të datës 06.06.2016, ka akuzuar të pandehurin I. Q. F. nga fshati B. komuna P., për shkak të veprës penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj nga neni 330 par.2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar publik më dt.02.02.2017, gjatë së cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, dhe i pandehuri I. F. .

I pandehuri I. F., në seancën e shqyrtimit fillestar publik, deklaroi se e pranoj fajin, është e vërtetë se rasti ka ndodhur ashtu, e ndiej vehten keq që ka ndodhur rasti, i kërkoj falje të dëmtuarit dhe i kam kërkuar falje sipas traditave, tani jam mbetur pa punë, më së keqi më ka ra mua, kam mbetur pa të ardhura, e di se kam gabuar është hera e parë që jam para gjykatës dhe për mua kjo është shumë e rëndë, i kërkoj falje edhe një herë gjykatës dhe i lutem të më shqiptoj një dënim sa më të lehtë.

Prokurori i Shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi se pajtohem me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ky pranim është bërë konform dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale, me vullnetin e plot dhe pa kurrfarë presioni nga ana e të pandehurit.

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar publik, andaj Gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Shpërdorimi i pasurisë së huaj nga neni 330 par.2 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpallë fajtorë dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në llojin dhe masën e dënimit, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i pandehuri, gjatë shqyrtimit fillestar publik e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale

e cila i vihet në barrë, ishte i sinqertë gjatë gjykimit, dhe ndien keqardhje për veprimet e tij për të cilët edhe i kërkon falje gjykatës, sjelljen e tij pas këtij rasti, është hera e parë që ka ra në kundërshtim me ligjin, premtimin se do të jenë shumë më të kujdesshëm në të ardhmen, ndërsa duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana rënduese gjykata gjeti dhe pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penalo-juridike, andaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 par.1 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor në bazë të dispozitave të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
P.nr.727/2016 më dt.02.02.2017

Gjyqtari:
Minir Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.